


Republika e Shqipërisë
Dhoma e Noterëve Tiranë
Notere Anisa G. Dizdari
Nr. 1610 Rep.
Nr. 387/1 Kol.



Taksa e Pullës
U PAGUA

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot më datë 05/12/2016 (Dymijë e gjashtëmbëdhjetë) në Tiranë para meje Notere **Anisa G. Dizdari**, Notere e Dhomës së Noterëve Tiranë, me Liçensë Nr.238, me NI PT L31925014A, që ushtror aktivitetin në studion e ndodhur në adresën Rr. "Dibrës", Nr.277, Tiranë u paraqitën personalisht palët si mëposhtë:

Shitësi: Marsela Ahmetaj, e bija e Hairit, lindur në Elbasan, e datëlindjes 25.10.1985, banuese në Tiranë në adresën Rr. "21 Dhjetori", shtetase shqiptare, madhore me zotësi të plotë dhe për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me Nr.Pasaporte BC5899327 dhe Nr.Personal I560250910, me cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë "BWB" sh.p.k., regjistruar pranë QKB-së me dt.30.05.2014, me NIPT L41730010L, e cila në këtë kontratë do të cilësohet si pala shitëse.

Blerësi: Gjergji Taho, i biri i Enverit, lindur në Tiranë, i datëlindjes 22.08.1982, banues në Tiranë në adresën Rr. "Musa Maçi", Nr.25, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr.Pasaporte BD7555024 dhe Nr.Personal I20822045F, i cili në këtë kontratë do të cilësohet si pala blerëse.

Kushte të përgjithshme:

Shoqëria "BWB" sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me dt.30.05.2014, me objekt të aktivitetit të saj: instalimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e impjanteve për rrjete telefonie fikse dhe mobile dhe menaxhimin e faturimit për trafikun telefonik brenda dhe jashtë Shqipërisë etj.sipas përcaktimeve të Ekstraktit të Regjistrit Tregtar lëshuar nga QKB-ja, me ortak të vetëm të saj Marsela Ahmetaj, e cila zotëron 100.00 (njëqind) kuota me të drejtë vote, përqindja e pjesëmarrjes 100(%), (ose 1 kuotë) të kapitalit me vlerë 2.100.000, 00 (dy milion e njëqind mijë) Lekë, e cila korrespondon me 100(%), përqindja e pjesëmarrjes të kapitali të shoqërisë.

Palët kanë rënë dakord paraprakisht për kalimin e titullit të pronësisë mbi kuotat dhe kapitalin e shoqërisë sipas përcaktimeve që do të bëhen në këtë Kontratë Shitje Kuotash, referuar edhe Vendimit të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "BWB" sh.p.k., dt.24.11.2016, për masën dhe mënyrën e kalimit të kuotave palës që pranon shitjen.

Përsa mësipër dhe bazuar edhe në nenin 73, të Ligjit Nr.9901, dt.14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar nga Ligji Nr. 129/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë të ndryshuar", palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 – Shitja e kuotave

Sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate, në datën e nënshkrimit të saj, pala shitëse i shet palës që blen dhe pala që blen do të pranojë shitjen nga pala shitëse, kuotat e shoqërisë sipas mënyrës së përcaktuar më poshtë:

Shitësi do t'i shesë blerësit dhe blerësi do të pranojë nga shitësi 100 % kuotave, me vlerë nominale prej 2.100.000, 00 (dy milion e njëqind mijë) Lekë, që përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë dhe çdo të drejtë që lidhet me to, të lira nga çdo barrë.

Neni 2 - Deklarimet dhe garancitë

Shitësi me anë të kësaj kontrate deklaron dhe garanton në lidhje me shoqërinë si dhe me transaksionin që parashikohet në këtë kontratë.

Shitësi deklaron dhe garanton se shoqëria është krijuar dhe themeluar sipas ligjeve shqiptare, nuk është në gjendje paaftësi paguese apo në falimentim.

Marsela Ahmetaj

Gjergji Taho

Shitësi deklaron se janë ndjekur rregullisht, të gjitha aktet ligjore dhe/ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar që duhet të ndërmeren nga ose për llogari të blerësit dhe që autorizojnë shitësin të lidh dhe të zbatojë këtë kontratë.

Neni 3 – Pronësia

Shitësi është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i të 1 (një) kuote që përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë.

Kuotat në shitje janë të lira nga çdo barrë e çfarëdo lloji dhe shitësi ka të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për ta shitur, për t'i kaluar apo transferuar dhe dorëzuar kuotat në shitje në përputhje me afatet e kontratës.

Nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje apo detyrim që krijon apo vendos barrë në lidhje me kuotat në shitje ose ndonjë numër kuotash të autorizuara, por të paemtuara në kapitalin e shoqërisë. Asnjë person nuk pretendon se ka të drejtë mbi ndonjë barrë të mundshme të lidhur, me kuotat që janë në shitje.

Neni 4 - Mënyra e kalimit të pronësisë së kuotave

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, shitësi e humbet të drejtën e pronësisë mbi 100,00 (njëqind) pjesë (ose 1 kuotë) të kapitalit me vlerë 2.100.000,00 (Dy milion e njëqind mijë) Lekë, e cila korrespondon me 100% të kapitali të shoqërisë.

Ortaku i vetëm i shoqërisë Marsela Ahmetaj, humbet pronësinë në masën 100% (një qind për qind), të kuotave të zotëruara prej saj, e cila korrespondon me 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë "BWB" sh.p.k., duke kaluar të drejtën e pronësisë blerësit Gjergji Taho, i cili bëhet ortak i vetëm dhe pronar i vetëm i 100% të titullit të pronësisë të kuotave të shitura të shoqërisë "BWB" sh.p.k., që përfaqëson vlerën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e këtyre kuotave.

Shoqëria tregtare "BWB" sh.p.k., pas realizimit të këtij transaksioni shitje kuotash, do të ketë si ortakë të saj:

- 1- Gjergji Taho, i cili zotëron kuotat në vlerën 2.100.000,00 (Dy milion e njëqind mijë) Lekë, me pjesëmarrje në përqindje në vlerën 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) kuotë.

Neni 5 - Premtime të përbashkëta të palëve

Palët do t'i sigurojnë njëra-tjetrës, çdo dhe gjithë informacionin e nevojshëm për përfundimin e këtij procesi.

Neni 6 - Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni

Kjo kontratë rregullohet nga ligji shqiptar.

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve në lidhje me këtë kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 7 -Të ndryshme

7.1 Ndryshimet

Cdo korigjim, ndryshim, zgjidhje apo heqje dorë nga ndonjë prej dispozitave të kësaj kontrate, do të jetë e vlefshme vetëm në qoftë se bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga ose për llogari të secilës palë.

7.2 Vlefshmëria e pavarur nga njëra-tjetra e dispozitave kontraktore

Në rast se një dispozitë ose detyrim sipas kësaj kontratë është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në një juridksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera, ose e këtyre detyrimeve në një juridiksion tjetër, nuk do të preket ose çënohet nga një fakt i tillë. Palët pranojnë se do të përpiqen të zëvendësojnë një dispozitë të pavlefshme ose të pazbatueshme në masën më të madhe të mundshme, për të përmbushur qëllimin e kësaj dispozite.

7.3 Njoftimet

Njoftimet ose komunikime të tjera sipas ose në lidhje me këtë kontratë (Njoftimi) do të jenë:

- Me shkrim

- Në gjuhën shqipe
 - Do të dorëzohen ose dërgohen me postë të shpejtë me kthim përgjigje ose faks, palës që duhet të marr njoftimin në adresën e caktuar nga pala përkatëse.
- Me përjashtim të rastit kur provohet se njoftimi është marrë më shpejt, njoftimi do të quhet i dhënë nëse:
- Është dërguar me postë, 10 ditë pune, pas postimit të tij
 - Është dërguar me faks, kur konfirmimi i dërgimit të tij është regjistruar nga faksi i dërguesit.

7.4. Kalimi i të drejtave

Kjo kontratë është detyrim ligjor dhe në përfitim të palëve, trashëgimtarëve të tyre dhe personave të cilëve u kalojnë këto të drejta.

Blerësi nuk mund të kalojë dhe transferojë të drejtat e tij sipas kësaj kontrate, plotësisht apo pjesërisht, pa miratimin paraprak me shkrim të shitësit, miratim i cili nuk do të refuzohet pa arsye.

7.5. Kostot dhe taksat

Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë kontratë, secila palë do të paguajë shpenzimet e saj në lidhje me negocimin, hartimin, nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj kontrate dhe të shtojcave të saj (nëse do të ketë). Të gjitha shpenzimet noteriale për nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj kontrate do të paguhet nga pala blerëse..

7.6. Tërësia e kontratës

Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis palëve që lidhet me objektin e kësaj kontrate.


Palët kishin rënë dakord paraprakisht për lidhjen e kësaj kontrate, une Noteria, redaktova vullnetin e tyre në pesë kopje të njëjta, në gjuhën shqipe dhe pasi palët e lexuan atë, e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e nënshkruan në prezencën time dhe unë Noteria e vërtetoj atë sipas ligjit.

Shitësi

Blerësi

NOTERE

ANISA G. DIZDARI



GJERGJI TALLI

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit:	D-2016120514594815
Data e Rezultatit te Kerkimit:	05.12.2016
Ora e Rezultatit te Kerkimit:	2:59:48PM
Lloji i Kerkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-028-281
Referenca e Perdoriesit:	

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

BWB SH.P.K.



Callengjef

Regjistri i Barrëve Sigurorese



Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

FATURË

Emri i Perdoruesit:

ANISA
GANI
DIZDARI

Adresa:

RR. E DIBRES; NR.277
TIRANE-TIRANE
SHQIPERI

Nr. i Llogarise:

400-028

Date:

05.12.2016

Pershkrimi:

D-2016120514594815

Balanca Perpara:

Leke 2,600.00

Debi

Leke 1,400.00

Balanca Aktuale:

Leke 1,200.00

Komente:

